



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER *JULED A. BEQIRAJ***

NR. 4645 REP.  
NR. 2411/2 KOL.

**KONTRATE SHITJE KUOTASH**

Sot më datën 10.09.2019, përpara meje Noterit Juled A. Beqiraj, Noter i Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Durrës, në zyrën time në adresën rr. "Egnatia", lagje nr. 4, Durres, u paraqitën personalisht:


**Z. Bledar Hasalamaj**, shtetas shqiptare, lindur ne Geshtej , Kukes , me date 09.09.1991 dhe banues ne \_\_\_\_\_ , mbajtes i ID me nr. Personal J10909021M, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne kete kontrate referuar si "**Shitesi**").

dhe

**Shoqeria "A&B K.P.N" Shpk**, e regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, datë 11.09.2018 me Nr.NUIS-i L82111054K me zyre qendrore ne Tirane , Njesia Bashkiake nr.5 , Lagja Selite, Rruga "SHYQYRI BRARI", Pll 14, Kati i peste , Pasuria nr.146/38+1-14, Zona Kadastrale 3292, e përfaqësuar nga administratoria **Znj. Neda Kalaj**, shtetase shqiptare, lindur ne Gjirokaster, me date 15.10.1984 dhe banuese ne \_\_\_\_\_ , mbajtese e ID me nr. Personal I46015079N, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne kete kontrate referuar si "**Bleresi**")

**MEQENESE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE:**

- Shitesi eshte njeri nga ortakët e shoqerise "**SGD Energji " Shpk**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar regjistruar me date 23.03.2016 prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me numer identifikimi NUIS L66523702K (ketu e me poshte e quajtur "**SGD Energji " Shpk**) kapitali i te ciles eshte **100,000** leke.
- Shitesi zoteron perkatesisht 1kuote prej **20% pjesmarrje** ne aksione tek shoqeria "**SGD Energji " Shpk**.
- Shitesi deshiron ti shes Bleresit 1 kuote prej **20%** pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise "**SGD Energji " Shpk**, shoqeri e cila eshte zoterohet nga **Z. Bledar Hasalamaj**.
- Shitesi ka deshire te shese kuoten qe zoteron dhe per kete shitje ka marre te gjithë pelqimet paraprake nga ortakët e tjere te shoqerise.
- Bleresi shoqeria "**A&B K.P.N" Shpk** eshte dakort dhe ka shprehur interes te bej te tijen kuoten me **20%** pjesmarrje ne shoqerine "**SGD ENERGY" shpk** qe Shitesi zoteron dhe njeherazi disponon mjetet financiare per te realizuar kete blerje .



**PER SA ME SIPER**, si dhe duke marre parasysh marreveshjet reciproke te permbajtura ne kete akt, palet bien dakord si me poshte vijon:

#### **NENI 1**

##### **BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE**

Sipas dispozitave te kesaj Kontrate, **Shitesi** nepermjet ketij akti i shtet **Bleresit dhe ky i fundit** blen 1 kuote e cila perfaqeson **20%** te kapitalit te shoqerise "**SGD Energji**" **Shpk**.

Kjo kuote blihet me cmimin e percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate

#### **NENI 2**

##### **ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES**

**2.1.** Çmimi i shitjes qe bleresi do ti paguaje shitesit per blerjen e kuotes objekt Kontrate eshte ne vleren prej 200,000 Leke (dyqind mije) , me poshte i quajtur "Çmimi i Blerjes", vlere e cila do te likujdohet nepermjet llogarise bankare nga Bleresi ne favor te Shitesit .

**2.2.** Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar" dhe konkretisht nenit 10 ku thuhet se "Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata", palet jane dakord qe:

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Bleresi, pra **Shoqeria "A&B K.P.N" Shpk**, fiton menjehere pronesine mbi Kuoten me 20% pjesmarrje ne shoqeritee "**SGD Energji**" **Shpk** me likujdim e cmimit.

#### **NENI 3**

##### **DEKLARATAT DHE GARANCITE**

**3.1.** Shitesi deklaron dhe garanton se:

- (i)** nenshkrimi dhe zbatimi e kesaj kontrate eshte autorizuar rregullisht ,
- (ii)** Shitesi ka nenshkruar dhe shlyer ne menyre te plote kuoten, objekt i kesaj Kontrate,
- (iii)** kjo kuote qe transferohet eshte e lire nga çdo barre apo ndonje pretendim tjeter ligjor nga pale te treta,
- (iv)** kjo Kontrate nenshkruhet rregullisht sot me date 10/09/2019, eshte shprehje e vullnetit te lire dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Shitesin,
- (v)** eshte mbajtur mbledhja pergjithshme e asamblese se ortakeve te shoqeris "**SGD Energji**" **Shpk** ku te gjithë ortaket kane qene dakord dhe kane pranuar qe Z. Bledar Hasalamaj te shese kuoten qe zoteron dhe te behen ortake me **Shoqerine "A&B K.P.N" Shpk**.

**3.2.** Bleresi deklaron dhe garanton se:

- (i)** nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate eshte autorizuar rregullisht ,
- (ii)** ka te drejten, dhe nuk ka ndonje ndalim ligjor apo te ndonje lloji tjeter, per te nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj,
- (iii)** kjo Kontrate nenshkruhet rregullisht sot ne date 10/09/2019, eshte shprehje e vullnetit te lire dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Bleresin,





**NENI 4  
TE NDRYSHME**

Kjo Kontrate, nenshkrhet ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe perben marreveshjen e plote midis paleve.

**NENI 5**

**LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET**

5.1. Problemet ne lidhje me ceshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.


5.2. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate u hartua nga une noteri ne 4(kater) kopje identike me nga 3(tre) faqe secila ,ne gjuhen shqipe dhe pasi iu lexua qarte paleve prej meje, ne te cilet me deklaruan se e kane kuptuar qarte permbajtjen e saj, pranojne se pasqyron vullnetin e tyre te lire e të plotë dhe pas kesaj e nenshkruan në pranine time dhe unë noteri e vertetoj atë konform ligjit.

**PALET**


**SHITESIT**

**Z. Bledar HASALAMAJ**



**BLERESI**

**Shoqerine "A&B K.P.N" Shpk  
Adminiatorori  
Z.Neda KALAJ**



Noter

